

[Data 01/11/2022]

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Sistemi elektronik për mbledhjen dhe menaxhimin e informacionit për fermerët në hapësirën territoriale të Bashkisë Tiranë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbimet e teknologjise se informacionit 72222300-0dhe Pajisje elektronike 31710000-6.

Vlera e Fondit Limit: 16.666.661 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë pa tvsh i përbërë nga dy vlera që u përkasin dy llogarive të ndryshme, respektivisht llogarisë për investime dhe asaj për shpenzime korrente, si më poshtë vijon:

- “Sistemi elektronik për mbledhjen dhe menaxhimin e informacionit për fermerët në hapësirën territoriale të Bashkisë Tiranë” në programin buxhetor “Investim (231)” me tipologji (Sistem Software + pajisje HW) me vlerë të fondit limit 13,333,333 (trembëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.
- “Sistemi elektronik për mbledhjen dhe menaxhimin e informacionit për fermerët në hapësirën territoriale të Bashkisë Tiranë” në programin buxhetor “Shpenzime operative (602)” me tipologji (mirëmbajtje dhe trajnim) me vlerë të fondit limit 3,333,328 (tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e njëzetë e tetë) lekë pa TVSH.

Shënim: Referuar rekomandimit nr. 6911 prot., datë 28.10.2020 të APP-së, vlerat e ofertës ekonomike të investimit dhe të mirëmbajtjes të ofruara nga operatorët ekonomikë nuk duhet të tejkalojnë vlerën e fondit limit të parashikuar në njoftimin e kontratës për këto zëra, pasi në të kundërt oferta do të konsiderohet si ofertë e dhënë mbi fond limit dhe si e tillë, nuk mund të kualifikohet.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, ku vlera e xhiros minimale për vitet financiare 2019,2020,2021, të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

.... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”. Kjo procedurë është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në

nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare është jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.

Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me

kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me:

a) Standartin ISO 9001:2015 (ose e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit

Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"(i ndryshuar). Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

b) Standartin ISO 27001 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë ne përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt- marrëveshjes.

Argumentimi: ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Referuar sa më sipër cituar, ky standard lidhet drejtpërdrejt me zërat e kërkuara në termat e referencës si:

- Faza përgatitore, analizim dokumentash.
- Identifikimin dhe diagnostikimin e detajuar për çdo problem apo keqfunksionim të komponentëve të sistemit apo të problemeve të sigurisë dhe të propozojë zgjidhjen përkatëse.
- Shërbimet e mirëmbajtjes së sistemit për një periudhë 24 (njëzetë e katër) muaj.
- Instalimi i sistemit në infrastrukturën IT.

Referuar sa më sipër, disponueshmëria e certifikatës ISO 27001, parë kjo në raport me natyrën e furnizimeve dhe shërbimeve të kërkuara, ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese dhe trajtimin e

informacionit konfidencial gjatë implementimit të saj, është një kërkesë në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet nga Autoriteti Kontraktor. Dhe është një kërkesë e domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës.

c). Operatori ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me standartin ISO 20000-1 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të shërbimit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi: Bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

ISO 20000-1 është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë për: ndjekjen konsistente të shërbimeve deri në kryerjen e plotë të tyre sipas kërkesave të DST-së. Standardi ISO 20000-1 përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohet në teknologjitë e informacionit.

Kjo çertifikatë siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet IT do të menaxhohen sipas standardeve më të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

Këto kërkesa janë në vetvete një garanci më tepër për suksesin e projektit

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë markën, modelin shoqëruar me katalogë ose broshura për tabletët që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme e specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. (Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre). Fleta ose fletët e katalogut/broshurës që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.

Argumenti: Ky kriter është vendosur bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), neni 40 pika 6/b, i cili përcakton se :

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

...b) fotografitë apo katalogët teknikë;

Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të zërit (tabletë) objekt kontrate, të ofertuar me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti

kontraktor, për pajisjet që propozon/oferton.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një personel teknik të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike, Inxhinieri Informatike, Teknologji Informatike, Informatikë, Informatikë Matematikë, Inxhinieri Matematike dhe Informatike, Informatikë Ekonomike, Telekomunikacion, Inxhinieri Telekomunikacion ose ekuivalente, që do të angazhohen në implementimin e projektit, me këto kompetenca:

- a. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente.
- b. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për "ITIL Foundation" ose ekuivalente.
- c. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si Microsoft Certified Solution Developer për Aplikime në web ose ekuivalente.
- d. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si Microsoft Specialist në Programming HTML5 me Java Script dhe CSS3 ose ekuivalente.
- e. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për DBA (Database Administrator) për administrimin e bazës së të dhënave ose ekuivalente.
- f. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Testues Programi ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesa për staf është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 41, pika 4 .

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

“

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit

....”

Në këtë kontekst, referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar, prania e stafit teknik të diplomuar sipas kërkesave të këtij kriteri, i jep siguri AK se Operatorit Ekonomik ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për realizimin e integritit, konfigurimeve, testeve dhe shërbimeve që do të mundësohen nëpërmjet kësaj kontrat (dhe jo vetëm) konkretisht:

..“

- *Instalimi i sistemit në Infrastrukturën ekzistuese në Institucion.*
- *Testimi dhe optimizimi i sistemit.*
- *Sigurimi/implementimi i një sistemi informatik që përmbush kërkesat funksionale dhe teknike të paraqitura nga autoriteti kontraktor.*
- *Kontraktori do të zhvillojë aplikacionin software për nevojat e Bashkisë Tiranë, do ta testojë atë në bashkëpunim me përdoruesit dhe do ta përgatisë për instalim në infrastrukturën përkatëse.*

..”

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente.

Argumentimi: Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti implementimi, që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të sistemit, testimit, trajnimit dhe dokumentimit të projektit.

Menaxheri i projektit, referuar kompleksitetit të projektit, afateve kohore të kryerjes së shërbimit, do të sigurojë që çdo pikë e shërbimeve, fazave të kërkuara të kryhen me sukses dhe cilësi si edhe në kohë e afat sipas përcaktimeve të dokumentave të tenderit.

- b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për "ITIL Foundation" ose ekuivalente.

Argumentimi: Një certifikim ITIL Foundation është një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimeve të kërkuara pjesë e termave të references dhe specifikimeve teknike, në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të autoritetit kontraktor. Kërkesa për certifikim ITIL Foundation ose ekuivalente, garanton ideimin dhe konceptimin e shërbimeve IT të projektit në mënyrë të menaxhueshme sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre, përfshirë këtu dhe shërbimet e mirëmbajtjes. Kërkesa për një punonjës të certifikuar për "ITIL Foundation" ose ekuivalente lidhet me rezultatet që duhet të përmbushen nga operatori ekonomik, për zhvillimin e sistemit, për analizimin, dhe instalimin e sistemit në infrastrukturën ekzistuese të Bashkisë Tiranë, si dhe për realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes sipas kërkesave të shprehura në termat e referencës ku përcaktohen dhe kohët e ndërhyrjeve dhe termat e tjera të nivelit të shërbimit SLA (shërbimet e mirëmbajtjes).

- c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si Microsoft Certified Solution Developer për Aplikime ne web ose ekuivalente .

Argumentimi: Microsoft Certified Solutions Developer për Aplikime në web, është një certifikim i cili provon ekspertizën në krijimin dhe vendosjen e aplikacioneve dhe shërbimeve moderne në internet.

Në Termat e referencës përcaktohet qartë se zgjidhja e kërkuar duhet të bazohet në ëeb (ëeb based) dhe për t’u ofruar zgjidhja e mësipërme është e domosdoshme që operatori ekonomik të ketë specialistë të certifikuar për zhvillim aplikacionesh MCSO për aplikime në web ose ekuivalente. Mbështetur në termat e referencës dhe specifikimet teknike, natyrës, shërbimeve të kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës në tërësi, si dhe në detyrat detyrat specifike të projektit, sipas fazave pwrkatwse, në përputhje me është e nevojshme kërkesa për punonjës të certifikuar si Microsoft Certified Solution Developer për Aplikime ne web (Web Application) ose ekuivalente

- d) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si Microsoft Specialist në Programming HTML5 me Java Script dhe CSS3 ose ekuivalente.

Argumentimi: Zhvillues të certifikuar për programim HTML5 me Java Script dhe CSS3 ose ekuivalente janë specialistë të certifikuar për të programuar ndërfaqe web, kërkesë kjo e cila përmbush standardet minimale dhe profesionale për të implementuar platformën sipas kërkesave

të kontratës. HTML5, Java Script dhe CSS3 janë komponentë të pandashëm të zhvillimit të aplikacioneve web. Për krijimin e ndërfaqeve web interaktive janë të domosdoshme njohuritë e përmendura në këtë kriter.

Kërkesa për zhvillues të certifikuar sipas kërkesave të këtij kriteri, gjykojmë se është e bazuar dhe e lidhur ngushtësisht me objektin e kontratës, për të përmbushur të gjitha funksionalitetet dhe kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Ky certifikim do të jetë i nevojshëm edhe për mirëmbajtje (marrëveshja SLA) apo përmiresim nëse do të kërkohet, të funksionaliteteve sipas kërkesave në termat e referencës.

- e) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për DBA (Database Administrator) për administrimin e bazës së të dhënave ose ekuivalente.

Argumentimi: Database Administrator ose ekuivalente është një certifikim i cili i ofron individëve aftësinë për të dizenuar, implementuar dhe menaxhuar databaza. Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të garantojë që Operatori Ekonomik ofertues është i aftë për krijimin dhe administrimin e databazës e nevojshme për funksionalitetet e sistemit të kërkuar si dhe mirëmbajtjen efciente të saj. Mënyra më e saktë dhe që minimizon risqet për konfirmimin e aftësive të stafit është pajisja me certifikata, dhe paraqitja e tyre si dëshmi kualifikimi. Prania e tyre jep garanci për shërbimet e mirëmbajtjes dhe operimin e sigurtë me elementët përbërës të databazës për të gjitha të dhënat, realizimet dhe të dhënat operacionale përkatëse.

- f) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Testues Programi ose ekuivalente.

Argumentimi: Kualifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor janë të domosdoshme për të garantuar një implementim, testim cilësor dhe dokumentim të sistemit të kërkuar dhe proceseve të punës të cilat kërkohet të automatizohen. Këto kritere janë vendosur për të garantuar njohuri të plotë teknike të ofertuesve mbi sistemin e propozuar në çdo nivel të tij. Kërkesat e projektit, konkretisht faza e testimit pjesë e termave të references, përfshijnë dhe testimin e proceseve të implementuara duke siguruar se cdo zhvillim i realizuar është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, më konkretisht nevoja për punonjës të certifikuar për testues të programi ose ekuivalente lidhet drejtpërdrejt me një nga detyrat dhe fazat e kërkuara:

- Testimi dhe optimizimi i sistemit.

“..."

Faza III – Faza e testimit të sistemit.

- *Gjatë kësaj faze gjithashtu do të kryhen testimet. Do të jetë detyrë e stafit të autorizuar të Bashkisë Tiranë (komisionit) që të përcaktojë vlefshmërinë e proceseve, funksioneve dhe të sistemit në tërësi.*

....”

Sa më sipër, Autoriteti Kontraktor si përfituesi direkt i këtij investimi, kërkon dhe argumenton se shërbimi i testimit duhet të udhëhiqet nga një specialist i cili zotëron kapacitetet dhe kualifikimin e nevojshëm për realizimin e testeve, duke garantuar mbarëvajtjen e sistemit dhe rrjedhimisht të kontratës në tërësi. Të gjitha defektet që mund të hasen gjatë testimit duhet ti nënshtrohen një procesi të ri-testimit në mënyrë që të eliminohen të metat/erretet në sistem.

Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikata.

Për të vërtetuar këtë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikata për specialistët e kërkuar;
- Diplomat ose vërtetime nga universitetet përkatëse;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilitin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B;
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi, paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):

Termet e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Argumentim i termave të referencës dhe specifikimeve teknike:

Objekti kryesor i këtij shërbimi, është ngritja e një sistemi elektronik i cili do të mundësojë mbledhjen, përpunimin dhe menaxhimin e informacionit për fermerët që ushtrojnë veprimtarinë në hapësirën territoriale të Bashkisë Tiranë, në funksion të hartimit të politikave eficiente për këtë kategori.

Objektivi i përgjithshëm, është si vijon:

Sigurimi i një sistemi informatik që do mundësojë:

- Regjistrimin e të dhënave të fermerëve që ushtrojnë veprimtarinë në hapësirën territoriale të Bashkisë Tiranë, nga punonjësit e terrenit; Regjistrimi i vendndodhjes përkatëse nga terreni.
- Të sigurojë raportimin në kohë dhe me cilësi nga punonjësit e terrenit drejt strukturave përgjegjëse në Institucion.

- Të sigurojë, gjenerojë, analizojë dhe raportojë të dhëna sipas kërkesave.
- Transparencë në të gjitha hallkat e përfshira në këtë proces dhe mundësi evidentimi problematikash për t'i adresuar në kohë.
- Saktësi e informacionit dhe akses në cdo kohë i të dhënave për vendimmarrje të bazuar mbi to;
- Sigurimi i tabletave për të mundësuar aksesimin e aplikacionit nga terreni.

Specifikimet teknike të këtij shërbimi, janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2 dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe OE të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara.

Specifikimet teknike, për zërin “Tabletë” janë hartuar mbështetur në nevojat e autoriteti kontraktues si dhe janë bazuar në “Specifikimet Teknike Standarde për vitin 2022” të publikuara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit konkretisht në Modelin Tablet Tipi 1.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: **“Sistemi elektronik për mbledhjen dhe menaxhimin e informacionit për fermerët në hapësirën territoriale të Bashkisë Tiranë”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverballi:

Dokumentat e tenderit

Termet e Referencës

NJËSIA E PROKURIMIT